


Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Gjilan

Opstina Gnjilane

Municipality of Gjilan



Islamic Relief Kosova

Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari

Direkcija za Poljoprivredu Šumarstvo

Department of Agriculture Forestry

DATË/A:	21.02.2024
PËR/ZA/TO	Për Fermerët e Komunës së Gjilanit
Njoftim	Zyrës së Kryetarit të Komunës së Gjilan-it z.Alban Hyseni
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari – z.Bajram Isufi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për Aplikim për subvencionim me “Panele Solare” për fermerët e Komunës së Gjilanit

Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të Islamic Relief- Zyra në Kosovë dhe Komunës së Gjilan-it. Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari, në bashkëpunim me organizatën Islamic Relief hapin thirrjen e aplikimeve për subvencionim me “Panele Solare”.

Ri-Vazhdohet - thirrja për aplikim për të gjithë fermerët e Komunës së Gjilanit, për fermerë të interesuar për Panele Solare.

1.PANELE SOLARE 16 (me kapacitet 3.6 KW)

Kriteret që duhet të plotësojë aplikuesi për Panele Solare:

Përparësi kanë fermerët të cilët plotësojnë këto kriterë:

1. Fermerët që mbarështojnë së paku 10 krerë lopë, 100 dele – dhi
2. Fermerët që mbarështojnë pula vojse ose brojler mbi 2000 mijë copë
3. Fermerët që prodhojnë perime në serra mbi 500m²
4. Fermerët që kultivojnë pemë drufrutore ose pemë të imëta mbi 1 hektarë
5. Fermerët që kultivojnë perime në fushë të hapur mbi 0.5 hektarë

Dokumentacioni i nevojshëm për Panele Solare:

1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
2. Fleta poseduese e patundshmërisë (original)
3. Certifikata e bashkësisë familjare
4. Regjistri i kafshëve në ambulancat veterinare (AVU)
5. Për pemëtarët dhe perimtarët - raporti EFR-së
6. Mbarështuesit e pulave vojse, brojlerëve të sjellin dëshminë e raportit të EFR-së

Fermerët përfitues duhet të participojnë me **20%** të çmimit real të Paneleve Solare.

Afati për aplikim është i hapur **10 (dhjetë)** ditë pune nga data **21.02.2024** deri më **05.03.2024**

Aplikimet të dorëzohen në **Qendrën për Shërbim me Qytetarë**.